



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I KONKURENCËS

UDHËZUES<sup>1</sup>

Nr. 3, datë 26.06.2019

**“Mbi dëmet që shkaktohen dhe veprimet që ndërmerren kur shkelen dispozitat e Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar”**

**1. Të përgjithshme**

1) Ligji 9121/2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, (këtu e më poshtë Ligji), i ndryshuar, zbatohet :

- Për ndërmarrjet dhe grupimet e ndërmarrjeve, të cilat, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, ndikojnë ose mund të ndikojnë në treg;
- Për të gjitha subjektet që e ushtrojnë veprimtarinë në territorin e RSH, si dhe për ato që e ushtrojnë veprimtarinë jashtë këtij territori, nëse pasojat e kësaj veprimtarie ndihen në tregun e brendshëm;
- Ndërmarrjet publike dhe ndërmarrjet, të cilave u janë dhënë nga shteti të drejta ekskluzive ose të drejta të veçanta;
- Ndërmarrjet, të cilave u është dhënë e drejta e ushtrimit të veprimtarisë në fushën e shërbimeve me interes ekonomik të përgjithshëm apo ato, të cilat kanë karakterin e monopoleve të orientuara drejt sigurimit të të ardhurave, për sa kohë dhe në atë masë që në ligj dhe në fakt nuk pengohet veprimtaria e tyre.

2) Neni 65 i Ligjit parashikon të drejtën e çdo personi që pengohet në veprimtarinë e vet nga një marrëveshje e ndaluar, sipas nenit 4 të ligjit ose nga një praktikë abuzive, sipas nenit 9

---

<sup>1</sup>Directive 2014/104/EU of the European Parliament and of the Council of 26 November 2014 “On certain rules governing actions for damages under national law for infringements of the competition law provisions of the Member States and of the European Union”. (32014L0104)

Direktiva 2014/104/EU e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 26 nëntor 2014 “Mbi disa rregulla që rregullojnë veprimet për dëmet e ligjit kombëtar për shkelje të dispozitave të ligjit të konkurrencës të Shteteve Anëtare dhe të Bashkimit Evropian” (OJ L 349, 5.12.2014)

të Ligjit, të mund të ngrejë padi në gjykatë dhe të pretendojë për eliminimin ose parandalimin e kufizimit të konkurrencës, që rrezikon të kryhet ose që është kryer në kundërshtim me këto nene si dhe të pretendojë shpërblim, pagesën ose kompensimin për dëmin e shkaktuar, sipas dispozitave të Kodit Civil.

- 3) Bazuar në dispozitat e Kodit Civil dhe të Kodit të Procedurës Civile, gjykatat luajnë një rol të rëndësishëm në zbatimin e rregullave të konkurrencës. Efektshmëria e plotë e neneve 4 dhe 9 të Ligjit dhe në veçanti efekti praktik i ndalimeve të përcaktuara në këto nene, kërkon që kushdo qoftë, individ, duke përfshirë konsumatorët dhe ndërmarrjet ose një autoritet publik mund të kërkojë dëmshpërblim para gjykatës për dëmin që u shkaktohet atyre nga një shkelje e këtyre dispozitave. E drejta e dëmshpërblimit zbatohet në mënyrë të barabartë për shkeljet e neneve 4 dhe 9 të Ligjit nga ndërmarrjet publike dhe nga ndërmarrjet që u janë dhënë të drejta të veçanta ose ekskluzive nga institucionet publike shqiptare sipas gërme c) të nenit 1 të Ligjit.
- 4) Veprimet për dëmet janë vetëm një element i një sistemi efektiv të juridiksionit gjyqësor në lidhje me shkeljet e ligjit të konkurrencës dhe plotësohen me mënyra alternative rregulluese, si zgjidhja e mosmarrëveshjeve konsensuale dhe vendimet e zbatimit të ligjit që nxitin palët për të ofruar kompensim.
- 5) Për të siguruar veprimtari gjyqësore efektive për zbatimin sipas ligjit civil dhe zbatimit efektiv publik nga Autoriteti i Konkurrencës, të dyja mjetet duhet të bashkëveprojnë për të siguruar efektivitetin maksimal të rregullave të konkurrencës. Është e nevojshme të rregullohet administrimi i këtyre dy formave të zbatimit në mënyrë koherente.
- 6) Autoriteti i Konkurrencës zbaton ligjin e konkurrencës në lidhje me marrëveshjet, vendimet e shoqatave të ndërmarrjeve ose praktikave të bashkërenduara brenda kuptimit të nenit 4 të Ligjit i cili mund të ndikojë në treg. Kur Autoriteti i Konkurrencës ose gjykata zbatojnë ligjin e konkurrencës ndaj çdo abuzimi të ndaluar nga neni 9 i Ligjit, ata duhet të zbatojnë gjithashtu nenin 9 të Ligjit. Në interes të funksionimit të duhur të tregut dhe për siguri më të madhe juridike dhe një fushë më të barabartë për ndërmarrjet dhe konsumatorët, është e përshtatshme që fushëveprimi i këtij udhëzuesi të shtrihet në veprimet për dëmet e bazuara në shkeljen e dispozitave të ligjit të konkurrencës. Zbatimi i rregullave të ndryshme mbi përgjegjësinë civile në lidhje me shkeljet sipas nenit 4 ose 9 të Ligjit, do të ndikonte negativisht në pozitën e paditësit në të njëjtën çështje dhe fushëveprimin e kërkesës të tyre dhe do të përbëjë pengesë për funksionimin e duhur në treg.
- 7) Çdo person mund të kërkojë dëmshpërblim për dëmin e pësuar kur ka një marrëdhënie shkakësore midis atij dëmi dhe shkeljes së ligjit të konkurrencës. Të gjitha rregullat që përcaktojnë ushtrimin e së drejtës për dëmshpërblim për dëmin që rezulton nga shkelja e nenit 4 ose 9 të Ligjit, nuk duhet të formulohen ose të zbatohen në një mënyrë që e bën

tepër të vështirë ose praktikisht të pamundur ushtrimin e të drejtës së dëmshpërblimit të garantuar.

- 8) Kushdo që ka pësuar dëmin e shkaktuar nga një shkelje e rregullave të konkurrencës, mund të kërkojë dëmshpërblim për dëmin reale (*damnum emergens*), fitimin e munguar (*lucrum cessans*) si dhe pagesën e interesave.
- 9) E drejta për dëmshpërblim njihet për çdo person fizik ose juridik, konsumatorë, ndërmarrjet dhe autoritetet publike pavarësisht nga ekzistenca e një marrëdhënieje të drejtpërdrejtë kontraktuale me ndërmarrjen që cenon, dhe pavarësisht nëse ka apo jo një gjetje paraprake të një shkeljeje nga Autoriteti i Konkurrencës.
- 10) Veprimet që ndërmerren për kompensimin e dëmeve të shkaktuara nga shkeljet e legjislacionit të BE-së ose të konkurrencës kombëtare zakonisht kërkojnë një analizë komplekse faktike dhe ekonomike. Provat e nevojshme për të vërtetuar vlefshmërinë e një padie për dëmet shpesh mbahen vetëm nga pala e paditur ose palët e treta dhe nuk janë të njohura ose të arritshme nga paditësi. Në këto rrethana, dispozita strikte ligjore që kërkojnë që paditësit të specifikojnë në detaje të gjitha faktet që kanë të bëjnë me çështjen e tyre dhe duhet të paraqesin prova saktësisht të specifikuara, mund të pengojnë padrejtësisht ushtrimin efektiv të së drejtës për dëmshpërblim të garantuar nga TFEU.
- 11) Provat janë një element i rëndësishëm i cili shërben për të kërkuar dëmshpërblimin e dëmit të shkaktuar nga shkelja e legjislacionit të BE-së ose atë kombëtarë të konkurrencës. Sidoqoftë, meqenëse mosmarrëveshja mbi ligjin e konkurrencës karakterizohet nga një asimetri informative, është e përshtatshme ti garantohet palëve e drejta e për të paraqitur provat relevante për kërkesën e tyre, pa qenë e nevojshme që nga ana e tyre të specifikohen elementët e saj. Për të siguruar që pala e paditur të ketë mjete ekuivalente për ushtrimin e të drejtës edhe i padituri si pjesë e vprimeve për dëmshpërblim duhet të ketë në dispozicion këto mjete, në mënyrë të tillë që kërkojë paraqitjen e provave nga ana e paditësve.
- 12) Kur provat të cilat përmbajnë sekrete biznesi ose informacione të tjera konfidenciale, duhet të vihen në dispozicion në veprimet që ndërmerren për dëmet, këto informacione konfidenciale duhet të mbrohen në mënyrë të përshtatshme. Për këtë arsye duhet të merren një sërë masash për të mbrojtur informacionet e tilla konfidenciale që të mos zbulohen gjatë procedurave. Këto masa mund të përfshijnë mundësinë e redaktimit të pjesëve të ndjeshme në dokumente, mbajtjen e seancave dëgjimore me kamera, kufizimin e personave për të parë provat dhe të udhëzohen ekspertët për të bërë përmbledhje të informacioneve në një formë të përmbledhur ose në një version jo konfidencial. Masat për të mbrojtur sekretet e biznesit dhe informacione të tjera konfidenciale megjithatë, nuk duhet të pengojnë ushtrimin e së drejtës për dëmshpërblim.

- 13) Parimi i proporcionalitetit duhet të vlerësohet me kujdes kur ka rrezik të zbulimit të informacioneve dhe të strategjisë së hetimit të Autoritetit të Konkurrencës, duke qartësuar cilat dokumente janë pjesë e dosjes dhe kanë riskun e pasjes së një efekti negativ në mënyrën se si ndërmarrjet bashkëpunojnë me Autoritetin e Konkurrencës. Një vëmendje e veçantë duhet ti kushtohet “*fishing expeditions*” - ekspeditave të peshkimit d.m.th. kërkimeve jo të specifikuar ose tepër të gjera të informacioneve që nuk janë shumë relevante për palët në një procedurë. Kërkesat për dhënien e informacioneve, nuk duhet të konsiderohen proporcionale kur ato i referohen zbulimit të përgjithshëm të dokumenteve në lidhje me një rast të caktuar ose zbulimin e përgjithshëm të dokumenteve të paraqitura nga një palë në kontekstin e një rasti të caktuar. Kërkesa të tilla të përgjithshme për dhënien e informacioneve nuk do të ishin të përshtatshme dhe detyra e palës kërkuese është të specifikojë sa më saktë dhe me kujdes provat apo kategoritë e provave.
- 14) Programi i lehtësimit nga gjobat është mjet i rëndësishëm për zbatimin e ligjit të konkurrencës, pasi ndihmon në zbulimin, ndjekjen dhe deri në vendosjen e sanksioneve për shkelje të rënda të ligjit të konkurrencës. Për më tepër, disa vendime të Autoritetit të Konkurrencës në rastet e marrëveshjeve të ndaluara bazohen në programin për lehtësimin nga gjobat dhe veprimet që kryhen për dëmet në rastet e marrëveshjeve të ndaluara zakonisht ndjekin këto vendime të dhëna dhe për këtë arsye programet e lehtësimit nga gjobat janë të rëndësishme gjithashtu në lidhje me dëmet që do të shkaktohen në rastet e marrëveshjeve të ndaluara. Ndërmarrjet mund të tërhiqen nga bashkëpunimi me Autoritetet e Konkurrencës në kontekstin e programeve të lehtësimit nga gjobat dhe procedurat e transaksioneve nëse deklaratat që përmbajnë dëshmi vetë-inkriminuese, siç janë deklaratat në lidhje me programin e lehtësimit nga gjobat dhe propozimet e transaksioneve, janë përpiluar/hartuar për qëllimin e vetëm të bashkëpunimit me Autoritetin e Konkurrencës. Një zbulim i tillë do të paraqiste rrezikun e ekspozimit të ndërmarrjeve bashkëpunuese ose stafit të tyre drejtues në përgjegjësinë civile ose penale nën kushte më të këqija se ato të bashkë shkelës që nuk bashkëpunojnë me Autoritetin e Konkurrencës. Për të siguruar gatishmërinë e vazhdueshme të ndërmarrjeve për t'iu drejtuar vullnetarisht Autoritetit të Konkurrencës me programin e lehtësimit nga gjobat, dokumentet e tilla duhet të përjashtohen nga paraqitja e provave. Ky përjashtim duhet të zbatohet edhe për citimet e folura/deklaratat verbale nga deklaratat e lehtësimit të dhëna. Për të siguruar që ky përjashtim të mos ndërhyjë padrejtësisht me të drejtat e palëve të dëmtuara për dëmpërblim, ky përjashtim duhet të kufizohet vetëm në ato deklarata vullnetare dhe vetë-inkriminuese të lidhura drejtpërdrejtë me programin e lehtësimit nga gjobat si dhe propozime për transaksione.
- 15) Çdo person fizik ose juridik që merr prova përmes qasjes/aksesit në dosjen e Autoritetit të Konkurrencës, duhet të jetë në gjendje të përdorë këto prova për qëllime të një veprimi për dëmet e pësuar në të cilat është palë. Një përdorim i tillë duhet gjithashtu të lejohet nga ana e çdo personi fizik ose juridik që ka pasur sukses në të drejtat dhe detyrimet e tij, duke përfshirë edhe marrjen e kërkesës së tij. Kur prova është marrë nga një person juridik që

është pjesë e një grupi korporatash që përbën një ndërmarrje për zbatimin e neneve 4 dhe 9 të ligjit, personat e tjerë juridikë që i përkasin të njëjtit sipërmarrje duhet të jenë në gjendje t'i përdorin këto prova.

- 16) Përdorimi i provave të fituara nëpërmjet qasjes/aksesit në dosjen e Autoritetit të Konkurrencës nuk duhet të zvogëlojë në mënyrë të padrejtë zbatimin efektiv të ligjit të konkurrencës nga një autoritet konkurrence. Për të siguruar që kufizimet në zbulimin e përcaktuar në këtë udhëzues të mos dëmtohen, përdorimi i provave dhe të dhënave të përmendura në pikën 15 që merret vetëm përmes qasjes në dosjen e autoritetit të konkurrencës duhet të kufizohet nën rrethana të njëjta. Kufizimi duhet të marrë formën e papranueshmërisë në veprimet për dëmet ose formën e ndonjë mbrojtjeje tjetër sipas rregullave në fuqi, të cilat mund të sigurojnë efektin e plotë të kufizimeve në zbulimin e këtyre llojeve të provave. Për më tepër, provat e marra nga Autoriteti i Konkurrencës nuk duhet të bëhen objekt tregtimi. Mundësia e përdorimit të provave që janë marrë vetëm përmes qasjes në dosjen e Autoritetit të Konkurrencës, duhet të kufizohet vetëm nga personi fizik ose juridik që i është dhënë fillimisht aksesit dhe trashëgimtarëve të tij ligjor.
- 17) Rregullat mbi fillimin, kohëzgjatjen, pezullimin ose ndërprerjen e afateve të kufizimit nuk duhet të pengojnë padrejtësisht kryerjen e veprimeve për dëmet. Kjo është veçanërisht e rëndësishme në lidhje me veprimet që ndërmerren bazuar mbi një gjetje nga autoriteti i konkurrencës. Për këtë qëllim, duhet të jetë e mundur të kryhet një veprim për dëmet pas procedimeve nga një autoritet konkurrence me qëllim të zbatimit të legjislacionit të konkurrencës. Periudha e kufizimit nuk duhet të fillojë të funksionojë para se të jetë ndaluar shkelja dhe para se paditësi të dijë ose mund të dijë sjelljen që përbën shkelje e faktin se shkelja ka shkaktuar dëmin e paraqitësit të kërkesës dhe identitetin e shkelësit.
- 18) Kur disa ndërmarrje shkelin së bashku rregullat e konkurrencës, si në rastin e një karteli, është e përshtatshme të parashikohet që ata të jenë bashkërisht dhe individualisht përgjegjës për të gjithë dëmin e shkaktuar nga shkelja. Çdo shkelës duhet të ketë të drejtën për kompensim nga bashkëpunëtorët e tjerë, nëse ka paguar më shumë sesa pjesa e tij. Përcaktimi i kësaj pjese si përgjegjësi relative e një shkelësi të caktuar dhe kriteret përkatëse si qarkullimi, pjesa e tregut ose roli në kartel, është një çështje e ligjit në fuqi, duke respektuar parimet e efektivitetit dhe ekuivalencës.
- 19) Ndërmarrjet që bashkëpunojnë me Autoritetin e Konkurrencës në kuadrin e programit të lehtësimit nga gjambat, luajnë një rol të rëndësishëm në paraqitjen e provave që vërtetojnë shkeljet në lidhje me një marrëveshje të ndaluar dhe sjell marrjen e një vendimi për ndalimin e këtyre marrëveshjeve. Në këtë mënyrë do të zvogëlohet demin i cili do të ishte shkaktuar nëse shkelja do të kishte vijuar. Është e përshtatshme të parashikohet që ndërmarrjet të cilat përfitojnë imunitet nga gjambat nga Autoriteti i konkurrencës sipas një programi lehtësues të mbrohen nga ekspozimi i panevojshëm nga padia për dmshtëpërblimin e dëmeve, duke pasur parasysh se vendimi i Autoritetit të Konkurrencës që konstaton

shkeljen mund të marri formë të prerë për përfituesin e imunitetit para se të marrë formë të prerë për ndërmarrjet e tjera të cilat nuk kanë marrë imunitet. Në këtë mënyrë përfituesi i imunitetit do të jetë subjekti preferencial i këtij procesit. Është e përshtatshme që përfituesi i imunitetit të lirohet në parim nga përgjegjësia e përbashkët për të gjithë dëmin dhe se çdo kontribut që duhet të jap kundrejt kundërvajtësve nuk tejkalon sasinë e dëmit që u shkaktohet blerësve direkt dhe indirekt ose në rastin e një marrëveshjes së ndaluar ofruesve të tij direkt ose indirekt. Kur një marrëveshje e ndaluar ka shkaktuar dëm edhe tek palët e tjera përveç se tek klientët ose ofruesit, kontributi i përfituesit të imunitetit nuk duhet të tejkalojë përgjegjësinë e tij për dëmin e shkaktuar nga marrëveshja e ndaluar. Kjo pjesë duhet të përcaktohet në përputhje me të njëjtat rregulla që përdoren për të përcaktuar kontributet midis shkelësve. Përfituesi i imunitetit duhet të mbetet plotësisht përgjegjës ndaj palëve të dëmtuara, përveç atyre blerësve apo ofruesve direkt ose indirekt, vetëm nëse nuk janë në gjendje të marrin kompensim të plotë nga shkelësit e tjerë.

- 20) Dëmi real i humbjes mund të vijë si rezultat i ndryshimit të çmimit ndërmjet çmimit që është paguar në të vërtetë dhe çmimit që e do të ishte paguar në mungesë të shkeljes. Kur një palë e dëmtuar e ka zvogëluar humbjen reale duke e kaluar në tërësi apo pjesërisht tek blerësit e vet, humbja e cila është kaluar nuk përbën më dëm dhe pala që e ka kaluar nuk duhet të kompensohet.
- 21) Në rastet kur kalimi i humbjes ka rezultuar në zvogëlimin e shitjeve duke sjellë dëm në formën e humbjes së fitimit, e drejta për të kërkuar kompensim për një humbje të tillë fitimi duhet të mbetet e paprekur.
- 22) Në varësi të kushteve nën të cilat operojnë ndërmarrjet, mund të jetë praktikë tregtare të kalohen rritjet e çmimeve poshtë zinxhirit të furnizimit. Konsumatorët ose ndërmarrjet të cilëve u është kaluar dëmi reale kanë pësuar dëmtime të shkaktuara nga shkelja e ligjit të Konkurrencës. Përderisa dëmi i tillë duhet të kompensohet nga shkelësi, mund të jetë veçanërisht e vështirë për konsumatorët ose ndërmarrjet që vetë nuk kanë bërë ndonjë blerje nga shkelësi për të provuar shkallën e dëmit. Kështu është e përshtatshme të parashikohet që, nëse ekzistenca e një kërkesë për dëmshpërblim ose shuma e dëmeve që duhet të jepen, varet nga fakti nëse, ose deri në çfarë shkalle një mbitarifim i paguar nga një blerës i drejtpërdrejtë nga shkelësi i është kaluar një blerësi indirekt, kjo e fundit konsiderohet se ka provuar se një mbitarifim i paguar nga ai blerës i drejtpërdrejtë ka kaluar në nivelin e tij ku është në gjendje të tregojë *prima facie* se një kalim i tillë ka ndodhur. Ky supozim i kundërshtueshëm zbatohet vetëm nëse shkelësi mund të tregojë në mënyrë të besueshme se dëmi real nuk është kaluar ose jo tërësisht në blerësin indirekt. Është gjithashtu e përshtatshme të përcaktohet se në çfarë kushtesh duhet të konsiderohet blerësi indirekt që ka provuar prova të tilla *prima facie*. Për sa i përket sasisë së kalimit, duhet të vlerësohet se cila pjesë e mbitarifimit ka kaluar tek blerësit indirekt.

- 23) Shkeljet e së drejtës së konkurrencës shpesh kanë të bëjnë me kushtet dhe çmimin me të cilin shiten mallra ose shërbime dhe çojnë në një mbitarifim dhe dëmtime të tjera për konsumatorët. Shkelja mund të ketë të bëjë edhe me furnizimet (për shembull, në rastin e kartelit të blerësve). Në raste të tilla, dëmi real mund të rezultojë nga një çmim më i ulët i paguar nga shkelësit tek furnizuesit e tyre.
- 24) Veprimet për dëmet mund të ndërmerren si nga ata që kanë blerë mallra ose shërbime nga shkelësi ashtu edhe nga blerësit e fundit të zinxhirit të furnizimit.
- 25) Pala e dëmtuar, e cila ka dëshmuar se ka pësuar dëm, si rezultat i një shkelje të së drejtës së konkurrencës, duhet të provojë shkallën e dëmit me qëllim të marrjes së dëmshpërblimit. Llogaritja e dëmshpërblimit në rastet e të drejtës së konkurrencës është një proces shumë i rëndësishëm bazuar në fakte dhe mund të kërkojë aplikimin e modeleve ekonomike komplekse. Kjo shpesh është shumë e kushtueshme dhe paraqitësit e kërkesave kanë vështirësi në marrjen e të dhënave të nevojshme për të mbështetur pretendimet e tyre. Llogaritja e dëmit në rastet e të drejtës së konkurrencës mund të përbëjë një pengesë thelbësore që parandalon kërkesa efektive për kompensim.
- 26) Në mungesë të rregullave për llogaritjen e dëmit të shkaktuar nga shkelja e ligjit të konkurrencës, duhet të përcaktohen rregullat për caktimin e dëmit dhe për të përcaktuar se cilat kërkesa duhet të plotësojë paraqitësi i kërkesës kur kërkon shumën e dëmit të pësuar, metodat që mund të përdoren në përcaktimin e sasisë dhe pasojat e mosplotësimit të plotë të këtyre kërkesave.
- 27) Për të korigjuar asimetrinë e informacionit dhe disa nga vështirësitë që lidhen me caktimin/llogaritjen e dëmit në rastet e të drejtës së konkurrencës dhe për të siguruar efektivitetin e kërkesave për dëmshpërblim, është e përshtatshme të supozohet se kartelet sjellin dëme, në veçanti lidhur me çmimet. Në varësi të fakteve të rastit, kartelet rezultojnë me një rritje të çmimeve ose parandalojnë uljen e çmimeve që do të kishte ndodhur, por për kartelin. Ky supozim nuk duhet të mbulojë vlerën konkrete të dëmit. Shkelësit lejohen të hedhin poshtë prezumimin. Është e përshtatshme të kufizohet ky supozim i kundërshtueshëm ndaj karteleve duke pasur parasysh natyrën e tyre të fshehtë, e cila rrit asimetrinë e informacionit dhe e bën më të vështirë për paraqitësit e kërkesave në marrjen e provave të nevojshme për të vërtetuar dëmin.
- 28) Është e dëshirueshme të arrihet një transaksion "përfundimtar" për të paditurin me qëllim zvogëlimin e pasigurive për palët e shkeljes dhe palët e dëmtuara. Prandaj shkelësit dhe palët e dëmtuara duhet të inkurajohen që të bien dakord për kompensimin e dëmit të shkaktuar nga një shkelje e ligjit të konkurrencës nëpërmjet mekanizmave konsensualë të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve, siç janë ato alternative jashtë gjykatës (duke përfshirë ato ku gjykatësi mund të deklarojë një vendim të detyrueshëm), ndërmjetësim ose pajtim. Një

zgjidhje e tillë konsensuale e mosmarrëveshjeve duhet të mbulojë sa më shumë palë të dëmtuara dhe shkelësit.

29) Afati i parashkrimit për të paraqitur një padi për dëmet e shkaktuara mund të jetë i tillë që të parandalojë palët e dëmtuara dhe shkelësit të kenë kohë të mjaftueshme për të arritur në një marrëveshje për kompensimin që duhet paguar. Për të siguruar që të dyja palët të kenë një mundësi për t'u angazhuar në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve konsensuale, para se ti drejtohen gjykatës, afati i parashkrimit duhet të pezullohet gjatë kohëzgjatjes së procesit të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve konsensuale ndërmjet palëve.

30) Për të inkurajuar një zgjidhje konsensuale, një shkelës që paguan dëmet përmes zgjidhjes konsensuale të mosmarrëveshjeve, nuk duhet të vendoset në një pozitë më të keqe kundrejt bashkë-shkelësve të tjerë, pozicion në të cilin do të ishte pa zgjidhjen konsensuale.

## **KREU I**

### **PËRMBAJTJA, QËLLIMI DHE PËRKUFIZIMET**

#### **Neni 1**

##### **Fusha e zbatimit**

Udhëzuesi përcakton rregulla të nevojshme për të siguruar që çdo person fizik apo juridik që ka pësuar një dëm të shkaktuar nga një shkelje e ligjit të konkurrencës, nga një ndërmarrje ose nga një bashkim ndërmarrjesh, mund të ushtrojë në mënyrë efektive të drejtën për të kërkuar kompensim të plotë për atë dëm të shkaktuar nga ajo ndërmarrje apo bashkim ndërmarrjesh. Udhëzuesi përcakton rregullat që nxisin konkurrencën e lirë dhe efektive në treg dhe heqjen e pengesave për funksionimin e duhur të saj, duke siguruar mbrojtje të lirë dhe efektive në gjithë territorin e RSH, për të gjithë ata që kanë pësuar një dëm të tillë.

#### **Neni 2**

##### **Përkufizimet**

Në këtë udhëzues, termat e mëposhtëm kanë kuptimet si më poshtë:

1. “Shkelje e ligjit të konkurrencës” nënkupton shkelje të nenit 4 dhe 9 të ligjit nr. 9121/2003 ‘Për Mbrojtjen e Konkurrencës’, i ndryshuar (këtu e më poshtë ligji);
2. “Shkelës” do të thotë një ndërmarrje ose bashkim ndërmarrjesh që ka kryer shkelje të ligjit të konkurrencës;
3. “Veprim për dëmshpërblim” nënkupton një veprim sipas dispozitave ligjore në fuqi, mbi bazën e të cilave paraqitet kërkesa për dëmshpërblim para një gjykate nga një palë e dëmtuar, ose nga dikush që vepron në emër të një ose më shumë palëve të dëmtuara, kur



- ligji parashikon këtë mundësi, ose nga një person fizik ose juridik që gëzon të drejtën e palës së dëmtuar, duke përfshirë edhe personin që legjitimohet në kërkesën e tij;
4. “Kërkesë për dëmshpërblim” nënkupton kërkesë për dëmshpërblim për dëmin e shkaktuar nga shkelja e ligjit të konkurrencës;
  5. “Palë e dëmtuar” nënkupton një person që ka pësuar dëmtime të shkaktuara nga një shkelje e ligjit të konkurrencës;
  6. “Autoriteti i Konkurrencës” nënkupton institucionin përgjegjës për zbatimin e Ligjit 9121/2003.
  7. “Gjykatë” nënkupton gjykatën kompetente para të cilave paraqiten kërkesat për dëmshpërblim, e cila është e autorizuar me anë të mjeteve të zakonshme të ankesës për të shqyrtuar vendimet e një autoriteti të konkurrencës;
  8. “Vendim i shkeljes” nënkupton një vendim të Autoritetit të Konkurrencës ose të një gjykate që konstaton shkelje të ligjit të konkurrencës;
  9. “Provat” nënkuptojnë të gjitha llojet e provave të pranueshme para gjykatës, në veçanti dokumentet dhe çdo provë tjetër që përmbajnë informacion;
  10. “Marrëveshje e ndaluar” nënkupton të gjitha marrëveshjet, të cilat kanë si objekt ose si pasojë pengimin, kufizimin ose shtrembërimin e konkurrencës në treg, veçanërisht marrëveshjet që: a) caktojnë, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, çmimet e blerjes ose të shitjes, apo çdo kusht tjetër tregtimi; b) kufizojnë ose kontrollojnë prodhimin, tregjet, zhvillimin teknik ose investimet; c) ndajnë tregjet ose burimet e furnizimit; ç) në marrëdhëniet tregtare me palët e tjera, zbatojnë kushte të ndryshme për transaksione të njëjta, duke i vendosur ato në gjendje të pafavorshme konkurrence; d) kushtëzojnë lidhjen e kontratave me pranimin nga palët e tjera kontraktuese të detyrimeve shtesë që, për nga natyra ose nga përdorimi i tyre tregtar, nuk kanë lidhje me objektin e këtyre kontratave
  11. “Programi i lehtësimit nga gjobat” është një instrument i rëndësishëm në luftën kundër marrëveshjeve të ndaluara, duke qenë se ai inkurajon ndërmarrjet që të ofrojnë informacion pranë Autoritetit të Konkurrencës, në lidhje me shkeljet e mundshme të konkurrencës. Një pjesëmarrës në një marrëveshje të fshehtë, pavarësisht nga ndërmarrjet e tjera të përfshira në këtë marrëveshje, bashkëpunon në një hetim të Autoritetit të Konkurrencës, duke ofruar vullnetarisht informacione, në këmbim për të cilin ai pjesëmarrës merr, me vendim ose me ndërprerjen e procedurës, imunitetin ose reduktimin e gjobave për përfshirjen e tij në marrëveshjen e ndaluar;
  12. “Deklaratë e lehtësimit” nënkupton një prezantim verbal ose me shkrim të ofruar vullnetarisht nga një ndërmarrje ose një person fizik, duke paraqitur dhe sjellë informacionin e kësaj ndërmarrjeje ose personi fizik lidhur me një marrëveshje të ndaluar dhe duke e përshkruar rolin e saj në të, i cili është paraqitur në mënyrë specifike për dorëzimin tek autoriteti i konkurrencës me qëllim të marrjes së imunitetit ose reduktimit të gjobave sipas një programi lehtësues, duke mos përfshirë informacionin e mëparshëm;
  13. “Informacion ekzistues” nënkupton dëshmi që ekzistojnë pavarësisht nga procedurat e Autoritetit të Konkurrencës;
  14. “Marrës i imunitetit” nënkupton ndërmarrjen ose personin fizik, që i është dhënë imuniteti nga gjobat nga Autoriteti i Konkurrencës, sipas programit të lehtësimit nga gjobat;

15. “Mbitarifim” nënkupton dallimin ndërmjet çmimit të paguar në fakt dhe çmimit që do të kishte mbizotëruar në mungesë të shkeljes së ligjit të konkurrencës;
16. “Zgjidhje konsensuale e mosmarrëveshjeve” nënkupton çdo mekanizëm që u mundëson palëve të arrijnë zgjidhjen jashtëgjyqësore të një mosmarrëveshjeje në lidhje me një kërkesë për dëmshpërblim;
17. “Zgjidhje konsensuale” nënkupton një marrëveshje të arritur nëpërmjet zgjidhjes së pajtimit konsensual;
18. “Blerës i drejtpërdrejtë” nënkupton një person fizik ose juridik i cili ka fituar direkt nga një shkelës, produkte ose shërbime që kanë qenë objekt i një shkelje të ligjit të konkurrencës;
19. “Blerësi indirekt” nënkupton një person fizik ose juridik, i cili ka fituar, jo drejtpërdrejtë nga një shkelës, por nga një blerës i drejtpërdrejtë ose një blerës i mëpasshëm, produktet ose shërbimet që kanë qenë objekt i një shkelje të ligjit të konkurrencës ose produkteve ose shërbimeve që përmbajnë ose rrjedhin prej tyre.

### **Neni 3**

#### **E drejta për dëmshpërblim të plotë**

1. Çdo person fizik ose juridik që ka pësuar dëmin e shkaktuar nga një shkelje e ligjit të konkurrencës ka të drejtë të kërkojë dhe të marrë dëmshpërblim të plotë për dëmin e pësuar.
2. Dëmshpërbimi i plotë, e vendos personin që ka pësuar dëm, në pozicionin në të cilin ai person do të ishte, nëse nuk do të kishte pasur shkelje të ligjit të konkurrencës. Prandaj, dëmshpërblim i plotë parashikon të drejtën e dëmshpërblimit për dëmin real, fitimin e munguar si dhe pagesën e interesave.
3. Dëmshpërblimi i plotë sipas këtij udhëzuesi, nuk do të çojë në mbi kompensim, qoftë me anë të ndëshkimeve, llojeve të ndryshme ose llojeve të tjera të dëmeve.

### **Neni 4**

#### **Parimet e efektivitetit dhe ekuivalencës**

Në përputhje me parimin e efektivitetit, duhet të sigurohet që të gjitha rregullat dhe procedurat ligjore që lidhen me ushtrimin e kërkesave për dëmet, të jenë hartuar dhe zbatuar në atë mënyrë që ato të mos bëjnë praktikisht të pamundur ose tepër të vështira ushtrimin e së drejtës për kompensim të plotë për dëmin e shkaktuar nga një shkelje e ligjit të konkurrencës.

## **KREU II**

### **PARAQITJA E PROVAVE**

#### **Neni 5**

##### **Paraqitja e provave**

1. Në procedurat që kanë të bëjnë me paditë për dëmet, me kërkesën e ankuesit ( i cili ka paraqitur një arsyetim të justifikuar që përmban fakte të mjaftueshme dhe prova të mjaftueshme për të

mbështetur besueshmërinë e kërkesës së tij për dëmshpërblim) duhet të parashikohet që paditësi ose pala e tretë të paraqesin provat përkatëse që ata zotërojnë.

2. Paraqitja e provave i nënshtrohet parimit të proporcionalitetit. Në çdo rast do të merret në konsideratë interesi legjitim i të gjitha palëve dhe palëve të treta në fjalë. Merret në konsideratë në veçanti:
  - a) masa në të cilën pretendimi ose mbrojtja mbështetet nga faktet dhe provat e disponueshme që justifikojnë kërkesën për paraqitjen e provave;
  - b) fusha e veprimit dhe kostoja e paraqitjes së provave, sidomos për çdo palë të tretë të interesuar, duke përfshirë parandalimin e kërkimeve jo specifike për informacion që nuk ka gjasa të jetë me rëndësi për palët në procedurë;
  - c) nëse provat përmbajnë informacione konfidenciale, sidomos për sa i përket palëve të treta dhe rregullimet ligjore përkatëse në lidhje me mbrojtjen e informacionit konfidencial.
3. Kur kërkohet paraqitja e provave që përmbajnë informacion konfidencial, vlerësohet rast pas rasti dhe duhet të merren masa efektive për të mbrojtur informacionin e tyre.
4. Në çdo rast duhet të garantohet mbrojtja e konfidencialitetit<sup>2</sup> kur kërkohet paraqitja e provave.
5. Në çdo rast duhet t'u sigurohet e drejta për të patur mundësinë e dëgjimit, të gjithë atyre të cilëve ju kërkohet që të paraqesin informacion.

## **Neni 6**

### **Paraqitja e provave të përfshira në dosjen e Autoritetit të Konkurrencës**

1. Me qëllim ndërmarrjen e veprimeve për dëmshpërblim, mund të urdhërohet paraqitja e provave, pjesë e dosjes së Autoritetit të Konkurrencës.
2. Kur vlerësohet proporcionaliteti dhe detyrimi për dhënien e informacionit, duhet të kihen parasysh:
  - a) nëse kërkesa është formuluar në mënyrë specifike në lidhje me natyrën, objektin ose përmbajtjen e dokumenteve të paraqitura tek Autoriteti i Konkurrencës ose të mbajtura në dosjen e institucionit;
  - b) nëse pala që kërkon paraqitjen e provave e bën këtë në lidhje me një padi për dëmshpërblim para një gjykate ; dhe
  - c) nevoja për të mbrojtur efektivitetin e zbatimit publik të ligjit të konkurrencës.
3. Mund të kërkohet paraqitja e kategorive të provave të mëposhtme vetëm pasi Autoriteti i Konkurrence me vendimin përkatës, ka mbyllur procedurat e tij:
  - a) informacioni që është përgatitur nga një person fizik ose juridik posaçërisht për procedurat pranë Autoritetit të Konkurrencës;
  - b) informacioni që Autoriteti i Konkurrencës ka hartuar dhe dërguar tek palët gjatë procedurave të tij;
4. Duke pasur si objektiv veprimet që ndërmerren për kompensimet për dëmet, në asnjë kohë nuk mund të urdhërohet një palë ose palë të tretë që të paraqesë ndonjë nga kategoritë e mëposhtme të provave:

---

<sup>2</sup>Në zbatim të nenit 10, të Ligjit nr. 55/2018 "Për profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë".

- a) deklaratat e lehtësimit në kuadër të Programit të lehtësimit nga gjobat.
5. Paditësi mund të paraqesë një kërkesë të arsyetuar që të ketë qasje në provat e përmendura në pikën 4 më sipër, me qëllimin e vetëm që të sigurojë që përmbajtja e tyre të përputhet me përkufizimet e pikës 11 të nenit 2. Në këtë vlerësim, mund të kërkojnë ndihmë vetëm nga Autoriteti i Konkurrencës. Autorët që kanë siguruar provat në fjalë gjithashtu mund të kenë mundësinë që të dëgjohen në këtë proces. Në asnjë rast, nuk duhet të lejohet që palët e treta të kenë qasje/akses në ato prova.
  6. Paraqitja e provave që gjenden në dosjen e Autoritetit të Konkurrencës dhe që nuk i përkasin kategorive të listuara në këtë nen, mund të urdhërohet në rastet e veprimeve që ndërmerren për kompensimin e dëmit .
  7. Paraqitja nga Autoritetit i Konkurrencës i provave të përfshira në dosjen e institucionit bëhet vetëm nëse asnjë palë e tretë nuk është në gjendje që të sigurojë dhe ofrojë këtë provë.
  8. Autoriteti i Konkurrencës paraqet observacionet e tij në lidhje me kërkesat për paraqitjen e provave para gjykatës.

## **Neni 7**

### **Kufizime në përdorimin e provave të fituara vetëm përmes aksesit në dosjen e Autoritetit të Konkurrencës**

1. Në çdo rast duhet që provat e siguruar sipas pikës 6 të nenit 6 më sipër, të cilat sigurohen nga një person fizik ose juridik vetëm përmes qasjes/aksesit në dosjen e Autoritetit të Konkurrencës konsiderohen të jetë e papranueshme në veprimet që ndërmerren për kompensimin e dëmeve ose ndryshe të mbrojtura sipas rregullave të zbatueshme për të siguruar efektin e plotë të kufizimeve në paraqitjen e provave të përcaktuara në nenin 6.
2. Deri në momentin që Autoriteti i Konkurrencës të ketë mbyllur procedurat e tij duke marrë një vendim ose në ndonjë mënyrë tjetër, dëshmitë sipas kategorive të listuar në nenin 6, pika 5, që merret nga një person fizik ose juridik vetëm nëpërmjet qasjes në dosjen e Autoritetit të Konkurrencës ose konsiderohet i papranueshëm në veprimet që ndërmerren për kompensimin e dëmit ose është i mbrojtur ndryshe sipas rregullave të zbatueshme për të siguruar efektin e plotë të kufizimeve në zbulimin e provave të përcaktuara në nenin 6.
3. Provat të cilat sigurohen nga një person fizik ose juridik vetëm nëpërmjet qasjes/aksesit në dosjen e Autoritetit të Konkurrencës dhe që nuk përfshihen në paragrafin 1 ose 2, mund të përdoren në një veprim që ndërmerret për dëmet vetëm nga ai person ose nga një person fizik ose juridik që ka marrë të drejtat e atij personi, duke përfshirë edhe një person që ka përfituar kërkesën e atij personi.

## **Neni 8**

### **Sanksionet**

1. Në çdo rast mundet që në mënyrë efektive të vendosen gjoba ndaj palëve, palëve të treta dhe përfaqësuesve të tyre ligjorë në rastet e përcaktuara si më poshtë:
  - a) dështimi ose refuzimi i tyre për të zbatuar urdhrin e paraqitjes të provave;
  - b) shkatërrimin e provave;

- c) dështimin ose refuzimin e tyre për të përmbushur detyrimet e vendosura, që mbrojnë informacionin konfidencial;
  - d) shkeljes së kufijve të përdorimit të provave të parashikuara në këtë Udhëzues.
2. Sanksionet duhet të jenë efektive, proporcionale dhe bindëse.

### **KREU III**

#### **EFEKTI I VENDIMEVE, AFATI I PARASHKRIMIT DHE DETYRIMI SOLIDAR**

##### **Neni 9**

###### **Efekti i vendimeve**

Vendimi përfundimtar i Autoritetit të Konkurrencës, në të cilin është konstatuar shkelja e dispozitave të ligjit të konkurrencës ose vendimi rishikues i nxjerrë nga gjykata lidhur me të, konsiderohet i pakundërshtueshëm për qëllime të paraqitjes të një padie për kompensimin e dëmeve para gjykatës.

##### **Neni 10**

###### **Afati i parashkrimit**

1. Në çdo rast mund të përcaktohen rregulla për afatin e parashkrimit lidhur me veprimet që ndërmerren për kompensimin e dëmeve. Këto rregulla përcaktojnë kur fillon afati i parashkrimit, kohëzgjatja dhe rrethanat nën të cilat afati është ndërprerë ose pezulluar.
2. Afati i parashkrimit<sup>3</sup> nuk fillon të llogaritet përpara se shkelja e ligjit të konkurrencës të ketë pushuar dhe paditësi të ishte në dijeni ose prezumohet se mund të ishte në dijeni:
  - a) të sjelljen dhe të faktit se kjo sjellje përbën shkelje të ligjit të konkurrencës;
  - b) të faktit se shkelja e ligjit të konkurrencës i shkaktoi dëm; dhe
  - c) të identitetit të shkelësit.
3. Afati i parashkrimit pezullohet ose ndërpritet, nëse Autoriteti i Konkurrencës ndërmerr veprime për qëllime hetimi ose në fillimin e një procedure në lidhje me një shkelje të ligjit të konkurrencës, me të cilën lidhet marrja e masave për kompensimin e dëmit. Pezullimi nuk mund të zgjasë më shumë se 1 (një) vit pasi vendimi për shkeljen ka marrë formë të prerë ose pasi procedurat të kenë përfunduar ndryshe.

##### **Neni 11**

###### **Detyrimi solidar**

1. Ndërmarrjet që kanë shkelur ligjin e konkurrencës përmes sjelljes së përbashkët janë solidarisht dhe individualisht përgjegjës për dëmin e shkaktuar nga shkelja e ligjit të konkurrencës, me efektin që secila prej këtyre ndërmarrjeve është e detyruar të kompensojë

---

<sup>3</sup> Në vendet anëtare të BE, periudhat e kufizimit për të ndërmarrë veprime për dëmet janë të paktën pesë vjet.

- dëmin në tërësi dhe pala e dëmtuar ka të drejtë të kërkojë kompensim të plotë nga secili prej tyre derisa të jetë kompensuar plotësisht.
2. Përrjashtim nga paragrafi 1, bëhet në rastet kur shkelësi është një ndërmarrje e vogël apo e mesme (SME) dhe shkelësi është përgjegjës vetëm për blerësit e tij direkt dhe indirekt, ku:
    - a) pjesa e saj në tregun përkatës ishte nën 5% në çdo kohë përgjatë shkeljes së ligjit të konkurrencës; dhe
    - b) zbatimi i rregullave normale të përgjegjësisë së përbashkët dhe të veçantë do të rrezikonin në mënyrë të pakthyeshme qëndrueshmërinë e saj ekonomike dhe do të shkaktonte humbje të vlerës së pasurisë së saj.
  3. Shmangia e parashikuar në paragrafin 2 nuk zbatohet kur:
    - a) SME-të kanë shkaktuar shkelje të ligjit të konkurrencës ose kanë detyruar ndërmarrjet e tjera të marrin pjesë në to; ose
    - b) SME-ja më parë është konstatuar se ka shkelur ligjin e konkurrencës.
  4. Përrjashtimisht nga paragrafi 1, duhet që një marrës i imunitetit (përrftues nga programi i lehtësimit nga gjobat) është përgjegjës solidarisht dhe individualisht si vijon:
    - a) tek blerësit e saj direkt ose indirekt; dhe
    - b) tel palët e tjera të dëmtuara, vetëm kur kompensimi i plotë nuk mund të merret nga ndërmarrjet e tjera që janë përrfshirë në të njëjtën shkelje të ligjit të konkurrencës.
  5. Një shkelës mund të rimarrë një kontribut nga çdo shkelës tjetër, shuma e të cilave duhet të përrcaktohet në përrputhje me përgjegjësinë e tyre në dëmin e shkaktuar, nga shkelja e ligjit të konkurrencës. Shuma e kontributit të një shkelësi, të cilit i është dhënë imuniteti nga gjobat sipas një programi lehtësues nga gjobat nuk duhet të tejkalojë sasinë/shumën e dëmit që shkaktohet tek blerësit ose ofruesit e tij direkt ose indirekt.
  6. Kur shkelja e ligjit të konkurrencës ka shkaktuar dëm për palët e dëmtuara, përveç atyre blerësve direkt ose indirekt ose ofruesve të shkelësve, shuma e çdo kontributi nga një marrës imuniteti ndaj shkelësve të tjerë do të përrcaktohet në përrputhje me përgjegjësinë relative të saj për atë dëm.

## **KREU IV**

### **KALIMI NË MBITARIFIM**

#### **Neni 12**

##### **Kalimi në mbitarifim dhe e drejta për kompensim të plotë**

1. Për të siguruar efektivitetin e plotë të së drejtës për dëmshpërblim, kompensimi i dëmit mund të kërkohet nga kushdo që e ka pësuar atë, pavarësisht nëse janë blerës direkt ose indirekt nga një shkelës. Në këtë rast duhet të shmangët kompensimi i dëmit që tejkalon atë që shkaktohet nga shkelja e ligjit të konkurrencës si dhe mungesa e përgjegjësisë së shkelësit.
2. Me qëllim të shmangies së mbitarifimit, duhet që kompensimi për dëmin real në çdo nivel të zinxhirit të furnizimit të mos e tejkalojë dëmin e mbitarifuar të pësuar në atë nivel.

3. Duhet patur parasysh që të mos cenohet e drejta e palës së dëmtuar për të kërkuar dhe për të marrë kompensim për fitimin e munguar për shkak të kalimit të plotë ose të pjesshëm të mbitarifimit.
4. Rregullat e përcaktuara në këtë pjesë, duhet të zbatohen në përputhje me rrethanat kur shkelja e ligjit të konkurrencës lidhet me furnizimin e shkelësit.
5. Duhet të vlerësohet, në përputhje me dispozitat ligjore, pjesa e çdo mbitarifimi që ka kaluar.

### **Neni 13**

#### **Përrjashtimi i trasferimit**

Parashikohet e drejta që i padituri mund të kërkojë kundër një kërkesë për dëmshpërblim, faktin që paditësi të ketë kaluar në tërësi ose një pjesë të mbitarifimit të ardhur nga shkelja e ligjit të konkurrencës. Barra e provës për faktin se mbitarifimi është transferuar bijë tek i padituri, i cili me arsye mund të kërkojë paraqitjen e provave nga paditësi ose nga palët e treta.

### **Neni 14**

#### **Blerësi indirekt**

1. Në rastet e një padie për dëmshpërblimin e dëmit, ekzistenca e një kërkesë për dëmshpërblim ose shuma e kompensimit që duhet dhënë, varen nga fakti nëse mbitarifimi është kaluar osë jo tek paditësi – dhe në cilën masë- duke marrë parasysh edhe praktikatat tregtare në të cilat rritjet e çmimeve kalojnë në zinxhirin e furnizimi, barra e vërtetimit të ekzistencës dhe të shumës i këtij transferimi bije tek paditësi, i cili mund të kërkojë paraqitjen e provave nga i padituri ose nga palët e treta.
2. Në situatën e përmendur në paragrafin 1, blerësi indirekt do të konsiderohet se ka vërtetuar se transferimi ka kaluar tek blerësi indirekt pra tek vetja e tij, në rastet kur tregohet se:
  - a) i padituri ka kryer shkelje të ligjit të konkurrencës;
  - b) shkelja e ligjit të konkurrencës ka rezultuar në një mbitarifim për blerësin e direkt i të paditurit; dhe
  - c) blerësi indirekt ka blerë mallra ose shërbime që kanë qenë objekt i shkeljes së ligjit të konkurrencës ose ka blerë mallra ose shërbime që rrjedhin prej tyre ose që i përmbajnë ato.

Ky paragraf nuk do të zbatohet nëse i padituri mund të vërtetojë në mënyrë të besueshme se mbitarifimi nuk ishte, ose nuk ishte kaluar tërësisht blerësit indirekt.

### **Neni 15**

#### **Veprimet për dëmet nga palët në niveleve të ndryshme në zinxhirin e furnizimit**

1. Për të shmangur që veprimet për dëmet nga palët e niveleve të ndryshme në zinxhirin e furnizimit të çojnë në një përgjegjësi të shumëfishtë ose në mungesë të përgjegjësisë së shkelësit, duhet që në vlerësimin lidhur me barrën e provës sipas neneve 13 dhe 14 të merren parasysh edhe ndonjë nga elementët e mëposhtëm:
  - a) veprimet për dëmet që lidhen me të njëjtën shkelje të ligjit të konkurrencës, por që janë ngritur nga ankimues/pretendues në nivele të tjera në zinxhirin e furnizimit;

- b) gjykimet që rezultojnë nga veprimet për kompensimet e dëmeve e përmendura në pikën (a);
- c) informacione të tjera në sferën publike që rezultojnë nga zbatimi i ligjit të konkurrencës.

## **KAPITULLI V**

### **PËRLLOGARITJA E DËMIT**

#### **Neni 16**

##### **Përllogaritja e dëmit**

1. Si barra e provës ashtu edhe standardi i provës që kërkohet për përllogaritjen e dëmit nuk e bëjnë ushtrimin e së drejtës për dëmshpërblim praktikisht të pamundur ose tepër të vështirë. Në çdo rast, duhet të vlerësohet shuma e dëmit, nëse është vërtetuar se një paraqitës i kërkesës ka pësuar dëm, por është praktikisht e pamundur ose tepër e vështirë për të saktësuar sasinë e dëmit të shkaktuar në bazë të të dhënave në dispozicion.
2. Supozohet se shkelja si pasojë e një marrëveshje të ndaluar shkakton dëm. Shkelësi ka të drejtën të kundërshtojë këtë supozim.
3. Në procedurat që kanë të bëjnë me një padi për dëmet, Autoriteti i Konkurrencës, ndihmon në lidhje me përllogaritjen e sasisë së dëmit kur ai vlerëson të përshtatshme një ndihmëse të tillë.

## **KREU VI**

### **ZGJIDHJA KONSENSUALE**

#### **Neni 17**

##### **Efekte pezulluese dhe efekte të tjera të zgjidhjes konsensuale të mosmarrëveshjeve**

1. Periudha e kufizimit për të paraqitur një padi për kompensimin e dëmeve, pezullohet gjatë kohëzgjatjes së çdo procesi konsensual të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve. Pezullimi i afatit të kufizimit do të zbatohet vetëm në lidhje për ato palë që janë ose që janë përfshirë apo përfaqësuar në zgjidhjen konsensuale të mosmarrëveshjes.
2. Autoriteti i Konkurrencës mund ta marrë në konsideratë kompensimin e paguar si rezultat i një zgjidhjeje konsensuale të një rasti, para se të marrë një vendim penalizues.

#### **Neni 18**

##### **Hyrja në fuqi**

Ky Udhëzues hyn në fuqi menjëherë.